



18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. Prot. 1540

Datë 15.08.2014

Lënda: Dërgohen dekretet e Presidentit të Republikës.

KUVENDIT

TIRANË

Bashkëlidhur, ju dërgojmë dekretet e Presidentit të Republikës:

- Dekret me nr. 8678 datë 15.08.2014 "Për kthimin e ligjit 100/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"".
- Dekret me nr. 8679 datë 15.08.2014 "Për kthimin e ligjit nr. 101/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", i ndryshuar".
- Dekret me nr. 8681 datë 15.08.2014 "Për kthimin e ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"".

Ju faleminderit!

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ARBEN IDRIZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI

DEKRET

PËR

KTHIMIN E LIGJIT Nr. 100/2014

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””.

Në mbështetje të neneve 85, pika 1 dhe 93, të Kushtetutës,


Dekretoj

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””.

Nr. Dekretit 8678
Tiranë, më 15.08.2014

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Amir
Nishani
BUJAR NISHANI



Komisionit të Ligjeve
[Signature]

**Arsyet e kthimit të ligjit nr. 100/2014
 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””**

Të nderuar deputetë,

Në seancën plenare të datës 31 korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””.

Ky ligj është paraqitur për shpallje më datë 04 gusht 2014. Në bindje të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ushtrim të drejtës së parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të Kushtetutës kam vlerësuar se ky ligj i duhet kthyer për rishqyrtim Kuvendit, mbështetur në arsyet dhe argumentet e mëposhtme.

Fillimisht, vlerësoj se ndryshimet dhe shtesat në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë plotësisht të nevojshme për të siguruar mbarëvajtjen dhe efikasitetin në punën e gjyqtarëve pranë gjykatave administrative të Shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ duke marrë në konsideratë mbingarkesën që kanë këto gjykata.

Por, në analizë të përputhshmërisë së ndryshimeve ligjore me Kushtetutën dhe jurisprudencën kushtetuese konstatova se procedura e emërimit, lirimit dhe shkarkimit nga detyra të ndihmësve ligjore (*neni 6/1 sipas ndryshimeve*) është në kundërshtim me parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe më konkretisht të pavarësisë së gjyqësorit e cila është një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës.

Kompetenca ekskluzive që i jep ligji 100/2014 kancelarit të gjykatës për të propozuar emërimin, lirimin apo shkarkimin e ndihmësve ligjor, i vendos këta të fundit *de facto* nën varësinë e tij. Kryetari i gjykatës, i cili *de jure* emëron, liron apo shkarkon ndihmësit ligjorë nuk bën gjë tjetër veçse formalizon një vendim të marrë nga kancelari i gjykatës, dhe nuk ka diskrecion për mospranimin e kandidaturës apo refuzimin e shkarkimit ashtu siç nuk ka diskrecion apo të drejtë përzgjedhjeje as vetë gjyqtari pranë të cilit do të punojë ndihmësi.

Lidhur me pozicionin e ndihmësit ligjor duhet t’i referohemi nenit 6 pika 2 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se: “*ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedural të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim*”. Nga kjo dispozitë del qartë roli i rëndësishëm që luan ndihmësi ligjor gjatë gjykimit dhe shqyrtimit të çështjeve. Për këtë arsye, për vetë natyrën delikate që ka shqyrtimi i çështjeve në gjykata, marrëdhënia e punës gjyqtar-ndihmës ligjor bazohet në mirëbesimin e gjyqtarit.

Bazuar në ndryshimet ligjore, lidhur me emërimin e ndihmësve, kancelari i gjykatës do të përzgjedhë dhe propozojë për emërim ndihmësin ligjor nga lista e kandidatëve fitues të shpallur pas testimit nga një komision *ad hoc* i cili do të organizohet dhe funksionojë bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë.

Pra, kryetari i gjykatës duhet të emërojë si ndihmës ligjorë patjetër një të kandidatuar nga kancelari i gjykatës i cili bazuar në nenin 37 pika 2 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se emërimi dhe shkarkimi i tij bëhen nga Ministri i Drejtësisë, është dukshëm në raport të drejtpërdrejtë varësie dhe kontrolli nga Ministri i Drejtësisë.

Raportet e caktuara që krijohen gjatë ushtrimit të veprimtarive shtetërore midis organeve dhe institucioneve qendrore kushtetuese që përfaqësojnë një nga tre pushtetet duhet që në çdo rast të mos cenojnë pavarësinë kushtetuese të secilit prej tyre. Pavarësia në vetvete ka si elementë të qenësishëm të saj pavarësinë organizative, pavarësinë funksionale dhe pavarësinë financiare (*Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007*).

Në gjykimin tim, ndryshimet që sjell ligji 100/2014, rrezikojnë seriozisht keto pavarësi kushtetuese, si dhe dhënia e kompetencave kaq të zgjeruara për kancelarët e gjykatave lidhur me emërimin e ndihmësve ligjorë krijon rrezikun e ndikimit të papërshtatshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit, dhënien e drejtësisë, si dhe i vendos strukturat brenda gjykatave në kushte të papërshtatshme për krijimin e marrëdhënieve të besimit, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin normal të funksionit të gjykatave.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 20, datë 09.07.2009, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën shprehjen e nenit 38/a të ligjit nr. 9877 datë 18.2.2008 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se kancelari i gjykatës: “a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës” ka shprehur qartazi se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. Në zbatim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, vlerësoj se me ndryshimet që sjell ky ligj, kancelarit i jepet një kompetencë edhe më e madhe nga ajo që i është hequr me vendim kushtetues.


Për sa më sipër, ndryshimet ligjore që sjell ky ligj, janë në kundërshtim me nenet 7 dhe 145 të Kushtetutës, me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe shkelin parimin kushtetues të shtetit të së drejtës.

Të nderuar deputetë,

Si përfundim, kërkoj mirëkuptimin tuaj në rishqyrtimin e ligjit nr. 100/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative””.

Me respekt,

PRESIDENTI I REPUBLIKËS



BUJAR NISHANI